



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN DHE PËRDORIMIN E
FAQES ZYRTARE TË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ”
GJIROKASTËR (WWW.UOGJ.EDU.AL)

Miratuar me vendim të Senatit Akademik nr.____, datë _____.____.2026

KREU I

PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Faqja zyrtare e Universitetit “Eqrem Çabej” përfaqëson platformën kryesore institucionale të komunikimit publik, transparencës administrative dhe prezantimit akademik. Kjo rregullore synon të krijojë një sistem të standardizuar dhe të qëndrueshëm të administrimit të faqes, ku çdo informacion i publikuar të jetë:

- i saktë dhe i verifikuar;
- i përditësuar në kohë reale;
- i strukturuar sipas hierarkisë institucionale;
- në përputhje me detyrimet ligjore dhe standardet e arsimit të lartë.

Nëpërmjet kësaj rregulloreje, faqja nuk konsiderohet thjesht si mjet informimi dhe transparence institucionale, por edhe si një mjet institucional për promovimin e veprimtarisë akademike, shkencore dhe administrative të universitetit, forcimin e komunikimit me publikun dhe garantimin e aksesit të palëve të interesuara në informacionin zyrtar të institucionit.

Neni 2

Baza ligjore

Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” neni 39, Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”; Ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër neni 60.

Neni 3

Parimet themelore të administrimit

Administrimi i faqes bazohet në parimet e transparencës aktive, llogaridhënies institucionale, qartësisë së përgjegjësive editoriale, sigurisë së informacionit, ndërkombëtarizimit dhe aksesueshmërisë.

KREU II

STRUKTURA E QEVERISJES SË FAQES

Neni 4

Modeli i administrimit

Faqja zyrtare administrohet sipas modelit të administrimit me përgjegjësi të shpërndara dhe koordinim qendror, ku administrimi teknik realizohet nga struktura përgjegjëse, ndërsa përgjegjësia për përmbajtjen i përket njësive përkatëse institucionale, nën mbikëqyrjen e qendrës koordinuese e cila do të përbëhet nga :

- Rektor
- Zëvendës Rektor për marrëdhëniet me jashtë dhe kërkimin shkencor
- Përgjegjësi i Sektorit të Teknologjisë së Informacionit, Promovimit dhe Inovacionit
- Specialist i inovacionit dhe menaxhimit të ëeb-it zyrtar
- Specialist i promovimit institucional dhe marrëdhënieve me publikun
- Juristi

Neni 5

Administratori Kryesor

Administratori Kryesor me detyrë “Specialist i inovacionit dhe menaxhimit të ëeb-it zyrtar” ka këto detyra:

- menaxhon platformën teknike;
- garanton stabilitetin dhe sigurinë;
- kontrollon akseset;
- verifikon përputhshmërinë e strukturës së faqes me standardet institucionale.

Ai nuk mban përgjegjësi për përmbajtjen substanciale të njësive.

Neni 6

Redaktorët institucionale

Çdo fakultet, drejtori, sektor apo njësi tjetër organizative e Universitetit cakton, me akt të brendshëm administrativ, një person përgjegjës për administrimin dhe përditësimin e përmbajtjes së seksionit përkatës në faqen zyrtare të institucionit.

Personi i caktuar mban përgjegjësi për:

- a) saktësinë, ligjshmërinë dhe karakterin zyrtar të informacionit të publikuar;
- b) faktin që çdo material i dërguar për publikim është paraprakisht i miratuar nga autoriteti kompetent;
- c) përditësimin periodik dhe në kohë të informacionit, në përputhje me ndryshimet organizative, akademike apo administrative.

Mosrespektimi i këtyre detyrimeve përbën përgjegjësi administrative sipas legjislacionit dhe akteve të brendshme në fuqi.

KREU III

POLITIKA E PUBLIKIMIT

Neni 7

Kategoritë dhe nivelet e publikimit

Publikimi i përmbajtjes në faqen zyrtare të Universitetit organizohet sipas një strukture të ndarë në nivele, me qëllim garantimin e qartësisë institucionale, standardizimit të informacionit dhe lehtësimit të aksesit për përdoruesit. Në këtë kuadër, përmbajtja klasifikohet në: publikime institucionale, të cilat përfshijnë aktet normative, vendimet e organeve drejtuese, statutin dhe dokumente të tjera me karakter zyrtar dhe detyrues; publikime akademike, që lidhen me programet e studimit, veprimtarinë kërkimore-shkencore, projektet dhe aktivitetet akademike; si dhe publikime informative, të cilat përfshijnë njoftime, lajme, aktivitete dhe materiale të tjera me karakter informues për komunitetin universitar dhe publikun e gjerë. Klasifikimi sipas këtyre niveleve synon të sigurojë organizim logjik të përmbajtjes, transparencë dhe menaxhim efikas të informacionit institucional.

Neni 8

Procedura editoriale dhe e publikimit

Çdo material i destinuar për publikim në faqen zyrtare të Universitetit i nënshtrohet një procedure të standardizuar editoriale, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, saktësisë dhe përgjegjësisë institucionale. Procedura përfshin verifikimin formal të dokumentit për sa i përket formatit, kompetencës së organit nxjerrës dhe përputhshmërisë me aktet në fuqi; kontrollin paraprak për respektimin e legjislacionit mbi mbrojtjen e të dhënave personale; validimin nga

njësia organizative përgjegjëse për përmbajtjen; si dhe publikimin nga administratori teknik i faqes. Zbatimi i kësaj procedure siguron gjurmueshmëri të procesit të publikimit, ndarje të qartë të përgjegjësive dhe llogaridhënie institucionale për çdo informacion të vendosur në dispozicion të publikut.

KREU IV

TRANSPARENCA DHE AKREDITIMI

Neni 9

Faqja zyrtare si instrument i sigurimit të brendshëm të cilësisë

Faqja zyrtare e Universitetit konsiderohet pjesë përbërëse e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe shërben si mjet institucional për garantimin e transparencës, informimit publik dhe evidencimit të proceseve akademike dhe administrative. Në këtë kuadër, faqja duhet të përmbajë dhe të mbajë të përditësuara dokumentet strategjike institucionale, raportet e vetëvlerësimit dhe dokumentacionin e lidhur me sigurimin e cilësisë, informacionin mbi proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, si dhe strukturën dhe përmbajtjen e programeve akademike. Publikimi i këtyre elementeve synon të mbështesë monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë, rritjen e llogaridhënies institucionale dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë.

Neni 10

Transparenca e përditësuar

Faqja zyrtare e Universitetit funksionon mbi parimin e transparencës aktive, duke synuar publikimin proaktiv dhe sistematik të informacionit me interes publik dhe institucional, në mënyrë që të sigurohet akses i drejtpërdrejtë dhe i lehtë për përdoruesit pa nevojën e paraqitjes së kërkesave individuale për informacion. Në këtë kuadër, njësitë organizative janë të detyruara të publikojnë dhe të përditësojnë në kohë dokumentet, aktet dhe materialet përkatëse, duke reduktuar barrën administrative të kërkesave për informacion dhe duke rritur transparencën, llogaridhënien dhe besueshmërinë institucionale.

KREU V

MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE SIGURIA DIGJITALE

Neni 11

Mbrojtja e të dhënave personale dhe privatësia

Publikimi i informacionit në faqen zyrtare të Universitetit respekton parimin e minimizimit të të dhënave, duke siguruar që të publikohen vetëm të dhënat e nevojshme dhe proporcionale me qëllimin e publikimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë. Çdo material i publikuar duhet të shmangë ekspozimin e panevojshëm të të dhënave personale dhe të garantojë trajtimin e tyre të ligjshëm, të drejtë dhe transparent, duke respektuar të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe standardet institucionale të sigurisë së informacionit.

Neni 12

Masat e sigurisë teknike dhe mbrojtjes së sistemit

Për garantimin e integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së informacionit të publikuar në faqen zyrtare, implementohen masa të detyrueshme teknike dhe organizative të sigurisë. Këto masa përfshijnë realizimin e kopjeve rezervë (backup) periodike të të dhënave dhe bazës së sistemit, aplikimin e mekanizmave të autentifikimit me nivele të diferencuara aksesesh sipas roleve dhe kompetencave të përdoruesve.

KREU VI

NDËRKOMBËTARIZIMI DHE AKSESUESHMËRIA

Neni 13

Ndërkombëtarizimi dhe aksesueshmëria digjitale

Faqja zyrtare e Universitetit duhet të ndërtohet dhe të mirëmbahet në përputhje me parimet e ndërkombëtarizimit dhe aksesueshmërisë digjitale, duke garantuar një version funksional në gjuhën angleze për përdoruesit ndërkombëtarë dhe një strukturë të qartë navigimi që lehtëson orientimin e studentëve dhe partnerëve të huaj. Platforma duhet të jetë e optimizuar për përdorim në pajisje mobile dhe të respektojë standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë, me qëllim sigurimin e aksesit të barabartë në informacion për të gjithë përdoruesit, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

KREU VII
MONITORIMI DHE PËRMIRËSIMI

Neni 14

Monitorimi dhe raportimi periodik

Administratori i faqes zyrtare përgatit raporte periodike 6-mujore monitorimi mbi funksionimin dhe performancën e platformës, të cilat përfshijnë analizën e trafikut dhe përdorimit të faqes, vlerësimin e performancës teknike dhe funksionale, si dhe gjendjen e përditësimit të përmbajtjes nga njësitë përgjegjëse dhe ja paraqet Rektorit. Raportet synojnë të identifikojnë problematika, të propozojnë masa për përmirësim të vazhdueshëm dhe të garantojnë përputhshmërinë e faqes me standardet institucionale të transparencës, cilësisë dhe sigurisë digjitale.

KREU VIII
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Përgjegjësitë

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje trajtohet sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore të Universitetit, përfshirë Kodin e Etikës së Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastër dhe aktet që rregullojnë përgjegjësinë administrative të personelit. Në rast konstatimi të shkeljeve, merren masat përkatëse administrative dhe disiplinore ndaj personave përgjegjës, në përputhje me procedurat dhe kompetencat e përcaktuara nga aktet institucionale në fuqi.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
PROF. DR JAHO CANA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”

SHTOJCË NR. 1
E RREGULLORES
“PËR ADMINISTRIMIN, MENAXHIMIN DHE PËRDORIMIN E FAQES ZYRTARE
TË UNIVERSITETIT “EQREM ÇABEJ” GJIROKASTËR (www.uogj.edu.al)”

PËR ADMINISTRIMIN DHE PËRDORIMIN E FAQEVE ZYRTARE TË
UNIVERSITETIT NË RRJETET SOCIALE FACEBOOK DHE INSTAGRAM

Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.____, datë ..2026

Neni 1

Qëllimi

Kjo shtojcë ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e faqeve zyrtare të Universitetit “Eqrem Çabej” Gjirokastrë në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram, si pjesë e komunikimit institucional, promovimit të veprimtarisë akademike, kërkimore-shkencore dhe forcimit të marrëdhënieve me publikun.

Faqet zyrtare në rrjetet sociale konsiderohen kanale plotësuese të komunikimit institucional dhe administrohen në përputhje me parimet e transparencës, korrektësisë, etikës, mbrojtjes së të dhënave personale dhe ruajtjes së imazhit institucional.

Neni 2

Administratori i faqeve zyrtare në rrjetet sociale

Administrimi teknik dhe publikimi i përmbajtjeve në faqet zyrtare të Universitetit në Facebook dhe Instagram realizohet nga administratori i caktuar me akt të brendshëm të Rektorit.

Administratori ushtron veprimtarinë në koordinim me strukturat përgjegjëse për promovimin institucional, marrëdhëniet me publikun dhe njësitë kryesore e bazë të Universitetit.

Neni 3

Detyrat e administratorit

Administratori i faqeve zyrtare në rrjetet sociale ka këto detyra:

- a) administron aksesin teknik në faqet zyrtare Facebook dhe Instagram të Universitetit;
- b) publikon informacionet, njoftimet, aktivitetet dhe materialet institucionale të miratuara sipas procedurave të brendshme;
- c) siguron që përmbajtja e publikuar të jetë në përputhje me identitetin, misionin dhe standardet institucionale të Universitetit;
- ç) përditëson në kohë informacionin mbi aktivitetet akademike, kërkimore-shkencore, ndërkombëtare, studentore dhe institucionale;
- d) koordinon marrjen e materialeve nga fakultetet, departamentet dhe strukturat administrative;

- dh) kujdeset për cilësinë vizuale, gjuhën e përdorur dhe paraqitjen profesionale të publikimeve;
- e) ruan konfidencialitetin e të dhënave të aksesit dhe merr masa për sigurinë e llogarive;
- ë) evidenton dhe raporton çdo problem teknik, akses të paautorizuar ose cenim të sigurisë së faqeve.

Neni 4

Të drejtat e administratorit

Administratori ka të drejtë:

- a) të kërkojë nga strukturat universitare informacionin dhe materialet e nevojshme për publikim;
- b) të përshtatë formatin teknik dhe vizual të materialeve për publikim në rrjetet sociale;
- c) të refuzojë publikimin e materialeve që nuk plotësojnë kriteret institucionale, cenojnë imazhin e Universitetit ose bien në kundërshtim me aktet ligjore dhe rregullatore;
- ç) të menaxhojë komentet apo ndërveprimet publike në rastet kur përmbajnë gjuhë fyese, diskriminuese, informacion të pavërtetë ose cenojnë etikën institucionale.

Neni 5

Rregullat e publikimit dhe komunikimit

Publikimet në faqet zyrtare të Facebook dhe Instagram duhet:

- të kenë karakter institucional dhe informues;
- të respektojnë etikën akademike dhe standardet e komunikimit publik;
- të mos përmbajnë opinione personale, qëndrime politike apo materiale që nuk lidhen me veprimtarinë e Universitetit;
- të respektojnë të drejtën e autorit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- të publikohen vetëm pas verifikimit të burimit dhe saktësisë së informacionit.

Neni 6

Mbrojtja e aksesit dhe siguria

Të dhënat e aksesit në faqet zyrtare të rrjeteve sociale janë pronë institucionale e Universitetit.

Administratori nuk lejohet të transferojë, ndajë ose përdorë aksesin për qëllime personale apo jashtë interesit institucional.

Në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës ose ndryshimit të detyrës, administratori dorëzon menjëherë akseset dhe të gjitha informacionet e lidhura me administrimin e faqeve.

Neni 7

Përgjegjësitë

Mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë shtojcë sjell përgjegjësi administrative sipas legjislacionit në fuqi, Kodit të Etikës dhe akteve të brendshme të Universitetit.

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Rregullores “Për administrimin, menaxhimin dhe përdorimin e faqes zyrtare të Universitetit ‘Eqrem Çabej’ Gjirokastër”.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
PROF. DR. JAHO CANA**